

Përgjigje e Kundërshtimit ndaj referatit për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Vizatim, Vizatim me pikturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës

Ankesa ndaj referatit për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Vizatim, Vizatim me pikturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës u shqyrtua me kujdes nga anëtarët e Komisionit recenzues në përbërje: prof. Xhelil Rufati – kryetar, prof. Agron Abduli – anëtar dhe prof. Zenun Sherifi – anëtar dhe Komisioni në fjalë e jep këtë Përgjigje në formë të raportit tekstual:

1. Kandidati Mr. Verim Zendeli pretendon që Komisioni recenzues nuk e ka përpiluar siç duhet vlerësimin me pikë tabelare.

Komisioni recenzues me përgjegjësi të plotë deklaron që shtojca tabelare ndaj referatit për zgjedhje është përpiluar në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014.

2. Kandidati pretendon se është paraqitur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në konkursin e shpallur nga ana e Universitetit të Tetovës.

Komisioni recenzues gjatë kontrollimit të dokumentacionit ka konstatuar se nga të tre kandidatët e paraqitur në konkurs vetëm kandidatja Mr. Drenusha Palloshi ka aplikuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit. Mr. Verim Zendeli nuk e posedon punimin e magjistraturës në origjinal me vulën e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës apo nënshkrime të anëtarëve të komisionit për mbrojtjen e temës së magjistraturës. Kjo vërejtje është shënuar edhe në raportin e shpallur në buletin e Universitetit.

3. Kandidati Mr. Verim Zendeli pretendon se në mënyrë të padrejtë i janë dhënë 42 pikë kandidatës Mr. Drenusha Palloshi për siç thotë mbajtjen e ligjeratave.

Komisioni recenzues e vlerëson si të pa bazë për faktin që sipas vërtetimit që posedon kandidatja Mr. Drenusha Palloshi që nga viti 2015 në vazhdimësi ka qenë e angazhuar nga ana e Universitetit si bashkëpunëtoresh në lëndën e Vizatimit ku i ka mbajtur vetëm ushtrimet. E njëjta vërehet edhe në aneks shtojcën e raportit të recenzionit ku është llogaritur konform Kriterëve për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtorë si dhe Rregulloren për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore. Mr. Drenusha Palloshi është e vetmja kandidatë që i plotëson kushtet - **përvojën në veprimtarinë mësimore-arsimore, aktivitetin artistik-profesional dhe aktivitetin profesional-aplikativ** si dhe ka arritur numrin e duhur të pikëve për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore **docent** në lëndën e Vizatimit.

Kandidati që ka parashtruar kundërshtimin nuk e plotëson kriterin themelor për zgjedhje në thirrje mësimore të paraparë me **nenin 164** të ligjit për arsimin e lartë siç janë „Kriteret për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtor:

1 - arsimi i fituar,

2 - rezultate nga punët e hulumtimit-shkencor dhe

3 - **rezultatet dhe përvoja në veprimtarinë mësimore dhe përgatitje të kuadrove të reja mësimore dhe shkencore-hulumtuese dhe nenit 167** për docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar në lëndët profesionale-artistike mund të zgjidhet edhe personi pa shkallë shkencore doktor shkence, që ka të kryer arsimin e lartë përkatës nga cikli i dytë, vepra të pranuar artistike dhe profesionale, përkatësisht realizime që kanë rëndësi themelore për afirmim të kulturës dhe artit në dhe jashtë shtetit, **si dhe aftësi për punë mësimore.**

PËRFUNDIM ME PROPOZIM

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, Komisioni recenzues konsideron që Kundërshtimi i kandidatit Mr. Verim Zendeli, është i pabazë. Komisioni recenzues në përbërje prof. Xhelil Rufati – kryetar, prof. Agron Abduli – anëtar dhe prof. Zenun Sherifi – anëtar, ka nderin e veçantë që edhe njëherë Këshillit të Rektoratit t'i propozojë që kandidati **Mr. Drenusha Palloshi** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **docent** për lëndët mësimore **Vizatim, Vizatim me pikturë** në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës.

Tetovë, 11.12.2018

Komisioni recenzues

Prof. Xhelil Rufati



Prof. Agron Abduli



Prof. Zenun Sherifi

